



KËRKIM NË FERMË

Titulli: Ndikimi i formave të mbajtjes së lajthisë në cilësinë e prodhimit.

Afati i zbatimit: 2018-2019

Punoi: A. Llambro; gjyliathina@yahoo.com

1. Hyrje

Në vendin tonë vitet e fundit ka pasur një tendencë në rritje, të sipërfaqes së mbjellë me kulturën e lajthisë për t'ju përgjigjur kërkesave gjithmonë e me shumë në rritje të tregut, drejt një produkti i cili ka qenë në sasi të ulët, por me vlera të larta në shëndetin e njeriut.

Për uljen e kostove të kultivimit ka teknika të reja kultivimi, në favor të mekanizimit të plotë, duke integruar praktika mbrojtje që respektojnë ruajtjen e ambjentit. Në vend të shkurre tradicionale, në mbjelljet e reja po preferohet forma e monokonit në variante të ndryshme: vazo e lirë, monokon, ypsilon dhe gardh. Tendenca aktuale është për rritje të numrit të bimëve për sipërfaqe, duke pasur parasysh nevojën për të favorizuar mekanizimin dhe realizuar ndriçim sa më të mirë. Teknologjia në drejtim të përmirësimit të cilësisë konsiston në: Përgatitjen e tokës si nivelim, shkrifërim të thellë dhe punim të lehtë nëpërmjet të cilit përmbysen plehrat organikë, fosforikë dhe potasikë. Plehrimet kryhen sipas fazave të prodhimit. Në fazën e prodhimit të plotë përdorimi i azotit duhet të jetë nga 100-150 kg/ha në impiantet nën ujë, me një raport NPK rreth 2-1-2, duke filluar përdorimin e azotit nga muaji Shkurt deri në muajin Korrik. Në krasitjen e bimëve, krasitja prodhuese kryhet çdo vit në mënyrë që të eliminohet 10-15 % e vegetacionit, duke lënë një sasi degësh me gjatësi 20-25 cm. Plotësimi i nevojave për ujë, kryesisht në zona me pak rreshje, është domosdoshmëri për të marrë prodhime të bollshme.

Lajthia gjen kushte të favorshme zhvillimi në kodra ose në vende të sheshta rrëzë maleve, në zona të ajrosura, por jo me erëra të forta. Duhet të evitohen zonat me lagështi të tepërt ajrore, mjegull, brymë dhe ngrica të vona. Lajthia jep prodhimtari të lartë në zona nga 150 deri 750 m mbi nivelin e detit. Prodhimi ulet jashtë këtyre ekstremeve. Në zona të ftohta duhet të preferohen ato të ekspozuara nga jugu, ndërsa në zona të nxehta ato të ekspozuara nga veriu. Lajthia jep prodhimtari në toka të lehta, të freskëta dhe të përshkushme nga uji.

Para mbjelljes është e rëndësishme të kryhen analizat e tokës për të verifikuar se të gjithë parametrat janë optimale për lajthinë dhe për të pasur të dhënat e duhura për kryerjen e plehrimeve të nevojshme.

Dendësia e mbjelljes shkon afërsisht 5 m x 5 m, me rreshta në drejtim veri-jug, për të shfrytëzuar në maksimum ndriçimin diellor dhe për të marrë maksimumin e mundshëm të prodhimit. Në mbjelljet e reja këshillohen shkrifërime, frezime të cilat duhet të jenë të shpeshta në fillim të frutifikimit. Një terren i shkrifët do të vështirësonte vjeljen mekanike të prodhimit. Kur ferma nuk ka pleh organik ose është e pa mundur të transportohet në vendin e mbjelljes, bëhet përmbysja e barërave konkurruese natyrale, duke furnizuar tokën me lëndë organike dhe

ujë. Mesatarisht në një bllok me lajthi në prodhim, duhet të bëjmë plehrime me: azot, fosfor dhe potas, afërsisht më pak se 1 kv/ha. Në mbjelljet e kryera në toka mbi ujë (kodër), është e rëndësishme që bimët të ujitën sipas rastit.

Projekti u hartua për t'u ardhur në ndihmë fermerëve të cilët kanë marrë përsipër të kultivojnë kulturën e lajthisë.

2. Vendi i ngritjes së studimit: Rrethi; Gjirokastrë; Fshati: Valare; Fermeri: Mihal Nasi

- Staf i pjesëmarrës në studim dhe ekstensionistë të DB Gjirokastrë etj.,
- Nga QTTB: Specialistët Athina Llambro, Lumturi Xhelilaj, Adhurim Lazaj.
- Nga Shërbimi Këshillimor Gjirokastrë: Balil Bineri.

3. Objektivi i kërkimit

Rritja e kërkesës së tregut për një prodhim cilësor nxjerr si domosdoshmëri zbatimin e një teknologjie bashkëkohore për arritjen e qëllimit final.

Ndikimi i formave të mbajtjes së lajthisë në cilësinë e prodhimit. Nëpërmjet ngritjes së provave mbi format e mbajtjes së kësaj kulture, të japim orientime të drejta për të gjithë kultivuesit e Lajthisë.

Në studim u vlerësua ndikimi i formave të mbajtjes së lajthisë në kapacitetin prodhues, cilësinë e prodhimit dhe ndikimi i saj në prodhimin e vitit pasardhës. Qëllimi i ngritjes së këtij studimi ishte të orientoj drejt fermerët që duan të mbjellin plantacione me lajthi dhe të jenë të kujdesshën në zbatimin e teknologjisë për të patur një prodhim të qëndueshëm për një kohë të gjatë dhe për të marrë prodhim cilësor.

4. Metodatat dhe materialet e përdorura:

Fillimisht, u kontaktua me DB Gjirokastrë, në bashkëpunim me Z. Balil Bineri, u vendos që studimi të kryhet në parcelën e Z. Mihal Nasi. U synuan parcela me moshë prodhimi, mbi 5 vjeçare. Në këtë parcelë bimët ishin uniforme nga madhësia dhe koha e mbjelljes së tyre. U mbajtën shënime rreth përbërjes së tokës në parcelën e mbjellë me lajthi si dhe disa të dhëna paraprake nga fermeri (sipërfaqja, numri i bimëve të mbjellë), dhe u morën treguesit e planifikuar në metodikë.

4. Ngritja e studimit

Zgjedhja e modelit të mbjelljes lidhet me shumë faktorë:

Modeli i mbjelljes varet nga:

- Pjelloria e tokës;
- Mundësia e ujitjes;
- Nevoja për të përdorur mjetet mekanike për trajtime;
- Nevoja për mbledhjen e mekanizuar të lajthive.

Në parcelën e mbjellë me lajthi në rrethin e Gjirokastrës studimi u krye në tre prova.

Secila provë përfaqëson një formë mbajtje të kurorës në bimën e lajthisë.

Prova e parë: Mbajtja e bimëve në formë shkurre

Prova e dytë: Mbajtja e bimëve në formë (vazo shkurre)

Prova e tretë: Mbajtja me një trung

Për secilën provë të kryer u morën në studim 10 bimë.



Figurë 1. Foto nga puna e stafit të projektit në parcelën e mbjellë me lajthi

Agronomëve ekstensionist iu vu në dispozicion dosja e projektit që përmbante projektin, kontratën, fletoren e fushës. Fermerit ju vu në dispozicion kryerja e analizave të tokës (përmbajtja e elementëve ushqyes si dhe nje sasi plehu kimik NPK (50kg). Kjo u realizua me fondet e projektit.

Treguesit e marrë në studim janë:

1. Sipërfaqja totale
2. Numri i bimëve; Distanca e mbjelljes
3. Zhvillimi i bimës
4. Pësia e prodhimit për bimë
5. Shpenzimet e kryera dhe të ardhurat e realizuara

Sipërfaqja totale e marrë në studim: 1.2 ha.

Numri i bimëve: 830 rrënjë.

Distanca e mbjelljes: 4 m x 3 m.

Tabelë 1. Të dhënat pedologjike dhe kimike të tokës

Horizonti	pH	Humusi %		N %		P ppm	
A2	7.1	1.4	V	0.118	M	2.7	V
A1	6.5	1.0	V	0.089	V	6.2	M
0-30	6.9	1.8	M	0.138	M	3.8	V

Të dhënat pedologjike të tokës u kryen në laboratorin e QTTB Fushë-Krujë.

5. Metodologjia

U mbajtën shënimet përkatëse mbi kohën e kryerjes së shërbimeve dhe matjet e treguesve të përcaktuar në metodikë diametri i kurorës (D+d), koha e pjekjes së frutit.

Gjatë kohës së pjekjes u morën pësia për çdo bimë dhe u analizua prodhimi mesatar për gjithë parcelën e mbjellë me lajthi.

Monitorimi ishte vizual. Treguesit u vlerësuan nëpërmjet matjeve dhe numërimeve, u regjistruan në fletore dhe u kompjuterizuan të dhënat.

Kompjuterizimi dhe përpunimi i treguesve u krye pas marrjes së gjithë treguesve. Hartimi i raporteve progresivë e përfundimtarë u realizuan konformë udhëzimeve.

Baza e nevojshme materiale u sigurua nga projekti.

Studimi u realizua nga specialistët e QTTB Vlorë dhe specialistët e DB Gjirokastër në periudhat e përcaktuara në metodikë. Ekstensionisti regjistroi në fletore fushe treguesit e matshëm, të cilën e dorëzoi tek drejtuesi i studimit në përfundim të marrjes së të dhënave të fundit për vitet e studimit. Pas marrjes së fletores së fushës, të dhënat u kompjuterizuan, u përpunuan dhe u hartua raporti përfundimtar.

6. Rezultatet

6.1 Treguesit e zhvillimit të bimës

Për matjen e vëllimit të kurorës të dhënat e para u kryen kur bima sapo ka filluar aktivitetin e saj dhe matjet e dyta u kryen në muajin Nëntor kur bima ka ndërprerë rritjen vjetore.

U kryen matjet e dy diametrave të kurorës dhe lartësisë së bimës në muajin Mars dhe muajin Nëntor.

Për matjen e Vëllimit të kurorës u përdor formula: $VC = \frac{2}{3}\pi D^2/4.H$

Tabelë 2. Vëllimi i kurorës për vitin e parë të studimit në Lajthi (m³)

Provat	Mars	Tetor	
	V1m ³	V2m ³	Rritja%
Prova1	1.32	1.48	12.1
Prova 2	1.44	1.59	10.4
Prova 3	1.39	1.55	11.5



Grafik 1. Paraqitja grafike e rritjes në % të vëllimit të kurorës


Për treguesin e vëllimit të kurorës për të tre format e mbajtjes së kurorës nuk ka shumë ndryshime përsa i përket rritjes në % të vëllimit të kurorës.

Në format e mbajtjes së kurorës ndikojnë shumë faktorë të tjerë si pozicioni i vendosjes së parcelës, numri i bimëve për ha, distancat e mbjelljes dhe struktura e tokës.


6.2 Prodhimi mesatar sipas provave

Tabelë 3. Prodhimi kg/rrënjë për çdo provë

Provat	Kg/rrënjë
Prova 1	3.4
Prova 2	4.4
Prova 3	2.8



Grafik 2. Paraqitja grafike e prodhimit për bimët e marra në studim sipas provave Pesha mesatare e frutit sipas provave



Grafik 3. Paraqitja grafike e peshës mesatare të frutit sipas provave

Për treguesit e prodhimit për bimë dhe peshës së frutit rritja më e madhe u gjet në provën e dytë mbajtja e bimëve në formë (vazo shkurre), krahasuar me provën e dytë dhe të parë. Në provën e dytë pesha e frutit ndyshonte ndjeshëm krahasuar me provën e tretë atë të mbajtjes së bimës me një trung.

6.3 Vlerësimi i rezultateve

- Nëpërmjet këtij studimi dhe pse në vitin e parë u qartësua më shumë se forma e mbajtjes së bimëve në kulturën e lajthisë varet nga disa faktorë: si pozicioni i vendosjes së parcelës, numri i bimëve për ha, distancat e mbjelljes, struktura e tokës. Përcaktimi i formës së mbajtjes së bimëve në kulturën e lajthisë është e rëndësishme për faktin se ka të bëjë me rritjen e prodhimit dhe gjithashtu me cilësinë e tij.
- Dhe pse në studim nuk janë evidentuar ndryshime të rëndësishme midis provave ku secila provë përfaqëson një mënyrë të ndryshme të mbajtjes së kurorës së bimëve çdo fermer që do mbjellë një parcelë me lajthi duhet të ketë patjetër asistencën e specialistit pasi është ai që do gjykojë mbi të gjithë faktorët dhe do të rekomandojë formën më të mirë të mbajtjes së

kurorës në bimët e lajthisë.

3. Aplikimi i formës më të përshtatëshme në kulturën e lajthisë duke marrë parasysh të gjithë faktorët e përmendur më lart të cilët ndikojnë në sasinë dhe cilësinë e prodhimit.

6.4 Opinionet e fermerëve dhe ekstensionistëve

Fermerët dhe ekstensionistët nëpërmjet studimeve që ndjek QTTB Vlorë për probleme të veçanta, si dhe ky studim, do të marrin asistencën e nevojshme për këtë kulturë e cila vitet e fundit ka marrë një vëmendje të veçantë në drejtim të rritjes së sipërfaqes së mbjellë dhe teknologjive të reja që po aplikohen.

7. Diskutime dhe konkluzione

Nëpërmjet këtij studimi përcaktimi i formave të mbajtjes së bimëve të lajthisë në përshtatje me kompleksin e faktorëve në zonën ku do të mbillet është e rëndësishme pasi përcakton sasinë dhe cilësinë e prodhimit.

1. Në vitin e parë të studimit ku u studjua forma e mbajtjes së kurorës u realizuan në parcelë të tre format e marra në studim.

2. Kryerja e gjithë shërbimeve agroteknoke në të tre provat ishte e njëjtë për të shmangur ndyshimet midis tyre.

3. Ndjekja hallkave të teknologjisë së kultivimit ndikon në rritjen e cilësisë së prodhimit gjë që në kushtet e sotme është e rëndësishme

4. Asistenca teknike e specialistëve është e rëndësishme pasi do të jetë specialisti i cili do të përcaktoj në bazë të faktorëve pedoklimatik gjithë investimin e fermerëve për këtë kulturë.

8. Aplikimi i përgjithshëm i tyre

Është i domosdoshëm zbatimi i të gjitha hallkave të teknologjisë së kultivimit të lajthisë me asistencën e specialistëve për të marrë një prodhim cilësor.

9. Mesazhet e ekstensionit

Zbatimi me rigorozitet i hallkave të teknologjisë së kultivimit të lajthisë për të marrë një prodhim cilësor.

10. Shpenzimet financiare të kryera

Nr. i artikullit	Emërtimi i Artikullit	Plani vjetor 000/lekë	Fakti 000/lek
602	Mallra e shërbime të tjera		
602.0	Materiale e shërbime zyre		
602.1	Materiale e shërbime speciale		
602.2	Analiza Toke	5	5
602.3	Shpenzime transporti		
602.4	Shpenzime udhëtimi		
	Brenda vendit		
	Dieta	10	10
Totali		15	15

11. Përhapja e rezultateve

Sugjerojmë për fermerët para mbjelljes së parcelave me lajthi të kenë parasysh zbatimin me korrektësi të teknologjisë së kutivimit të kulturës që do mbillet duke marrë asistencë teknike nga specialistë të fushës.

12. Metoda

Metoda e zbatimit të mesazhit të ekstensionit nga fermerët bazohet në marrëdhëniet e mira të ndërsjellta të DRB Gjirokastrë dhe QTTB Vlorë, në demonstrimin e rezultateve të studimit.

Hartimi i fletë-palosjeve, organizimet e seminareve, demonstrimeve, ditëve të fushës, filmimet e transmetimet televizive etj., nga stafi i studimit në përfundim të studimit.